

Bazuar në nenin 35 paragrafi 1.1. të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) dhe nenet 3.3, 9, 11, 13, 19 dhe 24 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe të Ndërmjetësuesve të Sigurimit, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2014, miratoi:

## **Rregullore për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime**

### **I. Të përgjithshme**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për licencimin e ndërmjetësuesve të sigurimeve.
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për të gjithë aplikuesit që kërkojnë licencë nga BQK-ja për t'u angazhuar në veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime.

#### **Neni 2**

#### **Përkufizime**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimeve dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimeve (në vijim: Rregullorja nr.2001/25) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - a) **“Ndërmjetësues sigurimi”** do të thotë agjent ose broker i sigurimeve që veprojnë si persona fizikë ose juridikë;
  - b) **“Agjent i sigurimeve”** do të thotë personi fizik i cili vepron në emër të një të Kompanie të Sigurimeve në përfaqësimin e shërbimeve dhe të produkteve të asaj kompanie. Agjentët e sigurimeve sipas kësaj rregullore mund të jenë agjent të jashtëm dhe agjent të brendshëm:
    - i. agjent i jashtëm konsiderohet personi fizik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontaktuar nga një kompani e sigurimeve sipas një kontrate për ndërmjetësim por i cili nuk është në marrëdhënie të rregullt pune me atë kompani dhe paguhet me anë të përqindjes apo pagesës fikse, apo sipas të dyja mënyrave nga kompania e sigurimeve të cilën e përfaqëson.
    - ii. agjent i brendshëm konsiderohet personi fizik i licencuar nga BQK-ja dhe i punësuar në një kompani të sigurimeve sipas një kontrate të rregullt të punësimit dhe i cili paguhet me pagë të rregullt;

- c) **“Kompani e agentëve”**– do të thotë person juridik i organizuar si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që krijohet me qëllim që të kryej veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe që vepron në emër dhe në llogari të një kompanie të sigurimeve;
- d) **“Brokeri i sigurimeve”** – do të thotë personi fizik që ushtron veprimtari ndërmjetësimi (brokerimi) në emër të siguruarve.
- e) **“Kompani e brokerimit”** – do të thotë personi juridik i organizuar si shoqëri aksionare apo si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që krijohet me qëllim që të kryej veprimtari të ndërmjetësimi (brokerimi) në sigurime në emër dhe llogari të të siguruarve.
- f) **“Rregullues i dëmeve”** do të thotë personi i licencuar si i tillë nga BQK-ja në pajtim me Rregullin 5 A për licencimin e rregulluesve/mbikëqyrësve të dëmeve të sigurimit të datës 28 mars 2002.

### **Neni 3** **Veprimtaria e Ndërmjetësimi në Sigurime**

1. Veprimtaria e ndërmjetësimi në sigurime në Republikën e Kosovës do të ushtrohet nga agjentë të sigurimeve, Kompanitë e agentëve, brokerët dhe kompanitë e brokerimit.
2. Ndërmjetësimi në sigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.
3. Askush nuk mund të ushtrojë veprimtari të ndërmjetësimi në sigurime në Republikën e Kosovës pa siguruar paraprakisht licencë nga BQK-ja.
4. Ndërmjetësit mund të licencohen për të përfaqësuar një apo me shumë produkte të sigurimeve, varësisht si licencohen.
5. Përveç siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni veprimtaria e ndërmjetësimi në sigurime mund të ushtrohet edhe nga bankat për të shitur të gjitha produktet e sigurimeve dhe për agjencionet e udhëtimit për shitjen e produktit sigurim i shëndetit në udhëtim, pasi ato të sigurojnë licencë nga BQK-ja. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës se bankës për licencimin e aktivitetit të ndërmjetësimi në sigurime do të kërkohet edhe mendimi i Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare.
6. BQK-ja mund të aprovojë kërkesat për të vepruar si ndërmjetësues i sigurimeve vetëm nëse veprimtaria e ndërmjetësimi nga paragrafi 1 i këtij neni edhe nga bankat e agjencionet turistike me kusht që këto të kenë së paku një person fizik të licencuar nga BQK-ja.
7. Bankat dhe agjencionet turistike të cilat kërkojnë licencë nga BQK-ja për të vepruar si ndërmjetësues të sigurimeve kërkohet të kenë parakontrata me një kompani të sigurimeve në emër dhe në llogari të të cilave do të veprojnë.

8. Kompanitë e sigurimeve në emër dhe në llogari të të cilave veprojnë ndërmjetësuesit e sigurimeve të licencuar sipas kësaj rregulloreje janë përgjegjëse të vetme para të siguruarve (policëmbajtësve).
9. Ndërmjetësuesit e licencuar do t'i nënshtrohen rregullimit dhe mbikëqyrjes nga ana e BQK-së.

## **II. Agjentët dhe kompanitë e agjentëve**

### **Neni 4**

#### **Kriteret e për licencimin e agjentëve në sigurime**

1. Çdo person i cili parashtron kërkesë për licencim si agjent në sigurime si person fizik duhet t'i plotësojë kriteret si në vijim:
  - a. të ketë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm;
  - b. të ketë dhënë provimin profesional për agjent;
  - c. të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 8 të kësaj rregulloreje nëse aplikon për licencim si agjent i jashtëm;
  - d. të mos ketë të hapur procedurë për ndonjë vepër penale dhe t'i plotësojë kërkesat e BQK-së për i përshtatshëm dhe i duhur të përcaktuara sipas Direktivës Evropiane nr. 2002/92;
  - e. të mos ketë detyrime tatimore të papaguara;
  - f. të mos jetë punëtor i rregullt i ndonjë kompanie sigurimi nëse aplikon për licencim si agjent i pavarur;
  - g. të ketë një parakontratë me një kompani të sigurimeve për të vepruar si agjent i saj, nëse aplikon si agjent i pavarur;
  - h. të jetë rezident i Republikës së Kosovës;
  - i. të ketë njohuri të njërës nga gjuhët zyrtare të Kosovës;
  - j. të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve në Kosovë në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare nëse aplikon si agjent i pavarur;
  - k. Polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale dhe certifikata e regjistrimit të biznesit nuk është e obligueshme të sillen në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit;
2. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për licencim nga paragrafi 1 i këtij neni BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme mund të kërkojë dokumentacion tjetër plotësues .

### **Neni 5**

#### **Kriteret për licencimin e kompanive të agjentëve**

1. Personi juridik që aplikon për licencim si kompani e agjentëve përveç kërkesave të nenit 13 të Rregullores nr.2001/25 duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
  - a. të jetë e regjistruar si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me ligjin për shoqëritë tregtare;
  - b. të jetë në gjendje të mirë financiare dhe të mos ketë obligime tatimore të papaguara;
  - c. të ketë të punësuar së paku një agjent të licencuar;

- d. të paguajë kapitalin themeltar prej 5,000 (pesë mijë) Euro në një rën nga bankat e licencuara nga BQK-ja;
  - e. themeluesit, drejtorët dhe menaxherët e saj të propozuar të mos kenë të hapur procedurë për ndonjë vepër penale dhe t'i plotësojnë kërkesat e BQK-së për i përshtatshëm dhe i duhur të përcaktuara sipas Direktivës Evropiane nr. 2002/92, si dhe të mos kenë qenë drejtues të ndonjë kompanie të sigurimeve gjatë 12 muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
  - f. të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 8 të kësaj rregulloreje;
  - g. të ketë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj;
2. Kërkesës për licencim si kompani e agjenteve duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:
- a. Formulari i BQK-së;
  - b. certifikatën e regjistrimit të biznesit;
  - c. statutin;
  - d. aktin e themelimit;
  - e. struktura organizative;
  - f. parakontrata e lidhur me kompaninë e sigurimeve në emër dhe në llogari të së cilës do të veprojë;
  - g. biografitë e plota të themeluesve, drejtorëve dhe menaxhereve të propozuar të kompanisë si dhe pasqyrat financiare nëse janë të aplikueshme;
  - h. plani i biznesit;
  - i. dokumentet që vërteton se kompania disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë saj, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave me Bankën Qendrore dhe kompaninë e sigurimit në llogari të së cilës punon;
  - j. dëshmi për sigurim nga përgjegjësia profesionale;
  - k. kopje të licencave të agjentëve;
  - l. dëshmi për pagesën e kapitalit themeltar;
  - m. dokumentacion tjetër që vërteton përmbushjen e kërkesave të nenit 5.1 më lartë;

### **III. Brokerat dhe kompanitë e brokerimit**

#### **Neni 6**

#### **Kriteret për licencimin e brokerëve në sigurime**

1. Çdo aplikues i cili parashtron kërkesë për licencim si broker në sigurime si person fizik duhet t'i plotësojë këto kushte:
  - a. të ketë diplomë fakulteti;
  - b. të ketë dhënë provimin profesional për broker;
  - c. të ketë përvojë pune së paku njëvjeçare në fushën e sigurimeve;
  - d. të mos ketë të hapur procedurë për ndonjë vepër penale dhe t'i plotësojë kërkesat e BQK-së për i përshtatshëm dhe i duhur;

- e. të mos jetë i punësuar në ndonjë kompani të sigurimit;
- f. të mos ketë qenë drejtor ekzekutiv apo anëtar i bordit i ndonjë kompanie të sigurimit që vepron ose që ka falimentuar gjatë 3 viteve të fundit;
- g. të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve në Kosovë në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- h. të mos ketë obligime tatimore të papaguara;
- i. të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 8 të kësaj rregulloreje;

## **Neni 7**

### **Kriteret për licencimin e kompanive të brokerimit**

1. Personi juridik që aplikon për licencim si kompani e brokerimit përveç kërkesave të nenit 13 të Rregullores nr.2001/25, duhet t'i plotësojë kushtet, si në vijim:
  - a. të jetë i regjistruar si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
  - b. të jetë në gjendje të mirë financiare dhe të mos ketë obligime tatimore të papaguara;
  - c. themeluesit, drejtorët dhe menaxheret e saj të propozuar të mos kenë të hapur procedurë për ndonjë veprë penale dhe t'i plotësojnë kërkesat e BQK-së për i përshtatshëm dhe i duhur, si dhe të mos kenë qenë drejtues të ndonjë kompanie të sigurimeve gjatë 12 muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
  - d. të ketë të punësuar së paku një broker të licencuar;
  - e. të paguajë kapitalin themeltar në shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) Euro, ky kapital duhet të paguhet në para të gatshme në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja;
  - f. të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenin 8 të kësaj rregulloreje;
  
2. Kërkesës për licencim si kompani e brokerimit duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:
  - a. Formulari i BQK-së;
  - b. certifikatën e regjistrimit të biznesit;
  - c. biografite e plota të themeluesve, drejtorëve dhe menaxherëve të saj si dhe pasqyrat financiare nëse janë të aplikueshme ;
  - d. organogramin;
  - e. parakontratat me kompanitë e sigurimeve të cilat mund t'i përfaqësojnë;
  - f. plani i biznesit;
  - g. dokumenti që vërteton se kompania disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë si broker në sigurime, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave në BQK;
  - h. dëshmi të sigurimit nga përgjegjësia profesionale;
  - i. kopje të licencave të brokerëve;
  - j. dëshmi të pagesës së kapitalit themeltar;
  - k. dokumentacionin tjetër që faton plotësimin e kriterëve nga neni 7.1 më lartë;

## **Neni 8**

### **Sigurimi i përgjegjësisë profesionale**

1. Ndërmjetësuesit dhe rregulluesit e dëmeve në sigurime obligohen që gjatë gjithë veprimtarisë së tyre të kenë policë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve e licencuar nga BQK-ja, për t'i mbuluar përgjegjësitet ndaj palëve të treta që lindin si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tyre, të kryera me dashje apo nga pakujdesia në vlerë prej 250,000 Euro për një rast të vetëm dhe 500,000 Euro për të gjitha rastet brenda 1 viti. Kjo shumë mund të ndryshohet nëse BQK-ja e sheh si të arsyeshme me anë të një udhëzimi të posaçëm.
2. Agjentët e brendshëm të sigurimeve nuk kërkohet ta kenë policën e përgjegjësisë profesionale nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **Neni 9**

### **Kërkesat financiare për rregulluesit e dëmeve**

Të gjithë rregulluesit e dëmeve të licencuar sipas rregullës 5 A të cilët veprojnë për dhe në emër të klientëve të tyre duhet të sigurojnë garancion bankar.

- a) Rregulluesit individual të dëmeve duhet të sigurojnë garancion bankar në shumë prej 5,000.00 (pesë mijë) Euro,
- b) Rregulluesit e inkuorporuar të dëmeve duhet të sigurojnë garancion bankar në shumë prej 20,000.00 (njëzet mijë) Euro.

## **IV. Provimi dhe trajnimet**

### **Neni 10**

#### **Provimi dhe trajnimet e vazhdueshme profesionale**

1. Provimi dhe trajnimet e vazhdueshme profesionale do të organizohen nga Shoqata e Sigurimeve apo subjekte tjera të aprovuara nga BQK-ja, në të cilin do të marrë pjesë një përfaqësues i Bankës Qendrore të Kosovës.
2. Përmbajtjet e testeve të provimit profesional për ndërmjetësues të sigurimeve duhet të aprovohen nga BQK-ja, e cila gjithashtu cakton komisionin. Një anëtar i komisionit do të jetë nga BQK-ja.
3. Këto teste në minimum duhet të përmbajnë pyetje bazike nga fusha e sigurimeve, drejtësia, etika profesionale, ekonomia dhe konfidencialiteti.
4. Shoqata e sigurimeve apo subjektet tjera për organizimin e trajnimeve profesionale duhet ta njoftojnë BQK-në për modulet e trajnimeve për ndërmjetësues të sigurimeve.

5. Agjentët në sigurime obligohen që të kenë edukim të vazhdueshëm profesional së paku 10 orë brenda vitit, kurse brokerët së paku 20 orë brenda vitit.

## **V. Dispozita të ndryshme**

### **Neni 11**

#### **Afati i shqyrtimit të kërkesës për licencim**

BQK-ja do të vendosë brenda afatit prej tre (3) muajsh lidhur me kërkesën për aplikacion të një ndërmjetësuesi të sigurimeve, prej datës së kompletimit të dokumentacionit.

### **Neni 12**

#### **Provizionet**

1. Secili personi fizik apo juridik që aplikon për t'u licencuar si ndërmjetësues (agjent dhe broker), si dhe rregullues i dëmeve në sigurime duhet të paguajë provizionin e licencimit në shumat e aprovuara nga BQK-ja.
2. BQK-ja mund të kërkojë nga ndërmjetësuesit e licencuar të paguajnë edhe provizione për ripërtëritjen e licencave në shumat e përcaktuara nga vet ajo.
3. Provizionet e përcaktuara nga paragrafi 1 dhe 2 janë të pakthyeshme.

### **Neni 13**

#### **Hapja e degëve te reja nga kompanitë e agjenteve dhe brokerëve**

Nëse një kompani e agjentëve apo e brokerëve vendos ta zgjerojë aktivitetin e vet, duke hapur degë të reja, duhet që paraprakisht të marrë aprovim nga BQK-ja.

### **Neni 14**

#### **Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

1. Ndërmjetësuesit e sigurimeve që janë licencuar dhe aprovuar sipas Rregullit 5 i datës 01 janar 2007 për ndryshimin e Rregullës 5 mbi mënyrën e shitjes së produkteve të sigurimeve dhe licencimin e operatorëve, të sigurimeve të detyrueshme, agjentëve dhe brokerëve i datës 5 dhjetor 2006, vazhdojnë të operojnë me licencën ekzistuese për produktet për të cilat janë licencuar. Ndërmjetësuesit që kanë licencë të vlefshme për shitjen e sigurimeve vullnetare mund të kërkojnë të licencohen sipas kësaj rregulloreje për shitjen e sigurimit nga autopërgjegjësia dhe produktet e tjera vullnetare.
2. Operatorët e sigurimeve të licencuar sipas Rregullës 5 mbi mënyrën e shitjes së produkteve të sigurimeve dhe licencimin e operatorëve, të sigurimeve të detyrueshme, agjentëve dhe brokerëve i datës 5 dhjetor 2006, vazhdojnë të operojnë me licencën ekzistuese sa i përket shitjes së sigurimit nga autopërgjegjësia dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj

Rregulloreje konsiderohen agjent të brendshëm të sigurimeve. Të njëjtit mund të kërkojnë të licencohen sipas kësaj Rregullore për shitjen e sigurimeve vullnetare.

3. Ndërmjetësuesit që janë licencuar sipas Rregullit 5 të datës 01 janar 2007 për ndryshimin e Rregullës 5 mbi mënyrën e shitjes së produkteve të sigurimeve dhe licencimin e operatorëve, të sigurimeve të detyrueshme, agjentëve dhe brokerëve i datës 05 dhjetor 2006 duhet ta përshtatin veprimtarinë e tyre me këtë rregullore brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të saj.

### **Neni 15 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulli 5 i datës 01 janar 2007 për ndryshimin e Rregullës 5 mbi mënyrën e shitjes së produkteve të sigurimeve dhe licencimin e operatorëve, të sigurimeve të detyrueshme, agjentëve dhe brokerëve i datës 05 dhjetor 2006 dhe Rregulli 6 mbi Rregullin e BPK-së mbi përshkrimin e kërkesave financiare për ndërmjetësuesit e sigurimit i datës 28 mars 2002, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me të.

### **Neni 16 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi më 1 shtator 2014.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore

---

Bedri Peci